# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449273**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ina Rama në trupën që gjykon mandatin e Ols Dados, prokurorin që vetë ia propozoi Presidentit Topi? |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/ina-rama-ne-trupen-qe-gjykon-mandatin-e-ols-dados-prokurorin-qe-vete-ia--i586488` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 13:06:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 13:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `204edca6d9d96d819f065dd259b31a93a08acd4093398e7f9f7ff68545e12079` |
| TEKSTI | `2c37e9f8d72ff60a36644a0c592c62a834e0f8f9df194e4cb8eae97df69773af` |
| PAMJA | `72b2d0a361ecc02aa3ab2e1adb6c49ff3603b7efc5a29e6d4a8e4b00ec1e8383` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f1c77daac1a387c7dc37faa6a416e2c2522047e5d2831fcba278e11146046e5b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9235283646fceb4f2e036f737b53ac1b0d6441cb2e31166fde86e3118480b863` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f1c77daac1a387c7dc37faa6a416e2c2522047e5d2831fcba278e11146046e5b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ina Rama në trupën që gjykon mandatin e Ols Dados, prokurorin që vetë ia propozoi Presidentit Topi?

16 Shtator 2026, 15:00Kronika TEMA



Këtë të mërkurë u hodh shorti në Gjykatën Administrative të Apelit për ankimin e kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, në çështjen që lidhet me emërimin e Ols Dados në detyrën e prokurorit.

Por, ndonëse në media u bë publike se kjo çështje do të shqyrtohet nga gjyqtarja Blerona Hasa, nga burime mësohet se pjesë e çështjes në fjalë është edhe Ina Rama.

Mirëpo, Ina Rama, në cilësinë e Prokurores së Përgjithshme në vitin 2008, i propozoi Presidentit të atëhershëm Bamir Topi emërimin e Ols Dados si prokuror. Vetë ish-Presidenti ka deklaruar publikisht se në Presidencë i ka ardhur një propozim formal nga ana e Prokurorse së Përgjithshme Rama.

Në këtë mënyrë, Ina Rama mund të gjendet sot në pozicionin e gjyqtares që duhet të shqyrtojë një çështje, objekti i së cilës lidhet drejtpërdrejt me ligjshmërinë e një emërimi të propozuar prej saj rreth 18 vite më parë.

Kodi i Procedurës Civile parashikon se gjyqtari duhet të heqë dorë nga një çështje kur ka interes në të, kur ka shfaqur më parë mendim për çështjen ose "në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie".

---

## Lini një Përgjigje

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Emërimi i prokurorit Ols Dado përfundon në Apelin Administrativ, hidhet shorti për ankimin e Veliajt]

11:10 Kronika / 28 komente

Po transportonte 6 shtetas të huaj drejt Tiranës, arrestohet 23-vjeçari në Korçë

10:20 Kronika

['Arsyet kanë tejkaluar ligjin'- Gjykata e Lartë e la Veliajn në qeli, avokati Ndreca: Po cenohet mandati i të zgjedhurit]

08:50 Kronika / 8 komente

[I akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, Gjykata Supreme e Brazilit jep dritën jeshile për ekstradimin e Ervin Matës në Shqipëri]




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.